



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 324/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj, për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 3 Nëntor 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI) dega në Ferizaj.

A r s y e t i m

Në ankesën e parashtruar ne PZAP, me datë 23.10.2013, nga subjekti politik PAI, dega në Ferizaj, pretendohet se PDAK përkatësisht nënkryetari i PDAK-së në Ferizaj, Qazim Rrahmani ka filluar Fushatën Zgjedhore parakohe, duke mos i respektuar afatet ligjore, si dhe ka kërkuar votën publikisht më datë 20.09.2013, (trembëdhjetë) 13 ditë para fillimit të fushatës zgjedhore, thuhet ne pretendimet e ankimuar.

Më këtë rast sipas parashtruesit te ankesës subjekti politik PDAK-ja, ka bërë shkelje të Rregullave mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi.

PZAP-i, duke vendosur sipas ankesës gjeti se:

ankesa është e palejuar

PZAP-i, duke u bazuar ne dispozitat e nenit 33, pika a), b), c) te LZP-së, me të cilin ndalohen veprimet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, po ashtu me nenin 44, 44.1 pikat a), b), c) të LZP-së, ju përcaktohen te drejtat subjekteve politike për veprimet e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Meqenëse pretendimet

ankimore të parashtruesit të ankesës janë zhvilluar para datës së caktuar për fillimin e fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 03.11.2013, siç përcaktohet me dispozitat e lartcekura ligjore, nuk mund të sanksionohet pretendimet e parashtruesit të ankesës ngase veprimet e ndërmarra nga Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PADK-ja) përkatësisht nënkryetarit Qazim Rrahmani duke e promovuar veten në rrjetin social (FB) me qëllim të bërjes së fushatës zgjedhore, këto veprime nuk sanksionohen me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe as me Rregullat Zgjedhore që PZAP-i të ndërmerr masa ligjore para fillimit të fushatës zgjedhore, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)

Anr. 324/2013 më datën 25.10.2013.



Kryesuesi i panelit
Nehat Idrizi

Këshill juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.